



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 623, datë 10.12.2020

PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE
LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN
E APELIT VLORË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS
PENALE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 545, DATË 05.11.2020,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 545, datë 05.11.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...}- relator z. Alban Toro

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR